REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 9200 prot.

Lushnje,më 17/10/2025

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda SEFA

Planit Strategjik 2026-2028 dhe Plani vjetor 2026

Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Lushnje

I. PLANI STRATEGJIK 2026-2028.

- **Qëllimi i Planit Strategjik dhe misioni i NJAB**

-Qëllimi i planit strategjik

NJAB mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike përgatit Planin strategjik dhe percakton punën qe do te behet nga njësia e auditimit të brendshëm për një periudhë 3-vjeçare.

Ky plan është element i rëndësishëm i kontrollit të brendshëm dhe hartohet për të siguruar titullarin që veprimtaritë e Bashkisë dhe subjekteve të vartësisë te mbulohen me auditim nga NJAB.

Planifikimi është një pjesë e rëndësishme e proçesit të auditimit, i cili përcakton dhe vlerëson drejtimet në të cilat do të zhillohet veprimtaria e strukturës së auditimit,kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave duke u bazuar në analizën e riskut se si mund të përdoren më me efektivitet burimet e auditimit. Kjo do të thotë të kuptosh njësinë që do të auditohet ,të përcaktosh dhe vlerësosh risqet, të përcaktosh objektivat e auditimit, fushën shtrirjet, kriteret si edhe mjetet e nevojshme për kryerjen e auditimit. Përgatitja e një plani strategjik të Auditimit të Brendshëm hartohet për një periudhë 3-vjeçare sipas skemës 1+2 vite dhe përditësohet çdo vit së bashku me miratimin e planit strategjik.

Qëllimi i planit strategjik është të përcaktojë dhe të vlerësojë veprimtarinë e strukturës së auditimit të brendshëm gjatë viteve 2026-2028.

Plani Strategjik dërgohet për miratim te Kryetari i Bashkisë Lushnje,pas miratimit i dërgohet Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Në planin strategjik janë parashikuar veprimtaritë kryesore të shtrira në të gjitha strukturat vertikale dhe horizontale të subjekteve në varësi të bashkisë.

Përgatitja e Planit Strategjik mundëson mbulimin me auditim të fushave/sistemeve të cilat janë të ekspozuara ndaj risqeve kryesore në veprimtarinë e Bashkisë Lushnje gjatë periudhës trevjeçare. Kryesisht për çdo vit planifikojmë të mbulojmë me auditim njësitë e vartësisë që janë njësi shpenzuese me llogari me vete,Drejtoritë edhe sektorët me risk më të lartë në bashki dhe Njësitë administrative.Mbulimi dhe auditimi i sistemeve apo fushave në bazë strukture do të gjenerojë të dhëna, përdorimi i të cilave do të shërbejë në përmirësimin e strukturave në lidhje me sistemet e kontrollit të brendshëm, bazën ligjore dhe udhëzimeve shtesë të ndryshme duke bërë të mundur arritjen e objektivave të organizatës.

-Misioni i NJAB

T'i japë siguri objektive Kryetarit të Bashkisë në aspektin e përdorimit dhe menaxhimit ligjor të vlerave monetare dhe materiale nga drejtuesit, punonjësit e administratës së bashkisë, ndërmarrjet dhe institucionet vartëse;Të kontrollojë përdorimin e buxhetit, zbatimin e normave ligjore, bazës materiale, ruajtjen e pasurisë publike në administrim të bashkisë dhe të kryejë aktivitet këshillimor, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të përformancës së institucionit.Misioni arrihet nëpërmjet kryerjes së auditimeve të përzgjedhura si rezultat i analizimit të regjistrit të riskut dhe proçeseve të vlerësimit:

Identifikim dhe vlerësim të riskut, duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut. Vlerësim të kontrolleve të cilat adresojnë riskun. të sigurojë titullarin e subjektit të audituar se fondet publike janë përdorur me ekonomi , efektivitet, efiçence dhe nxitjen për përmirësim të vazhdueshëm. Për funksionimin e elementëve të menaxhimit financiar (ambjentin e kontrollit, menaxhimin e rriskut, aktivitetet e kontrollit ,informimi dhe komunikimi dhe monitorimi).

- Rekomandimin e përmirësimit të kontrolleve në ndihmë të proçesit të qeverisjes për:


1. Promovimin e etikës dhe vlerave të duhura për njësinë;
2. Sigurimin e menaxhimit efektiv të përformancës dhe pergjegjshmërisë së njësisë;
3. Në mënyrë efektive të komunikojnë rrezikun dhe kontrollet në zonat e duhura të njësisë.

Për përmbushjen e objektivave dhe arritjen e qëllimeve të njësisë.
Të minimizojë mundesinë e riskut për mashtrim,shpërdorim dhe abuzim.
Të ndihmojë menaxhimin duke ofruar rekomandime lidhur me veprimtarinë e subjektit që ka vlerësuar .

- **Organizimi NjAB dhe Kuadri Ligjor.**
- **- Organizimi i NJAB**

Struktura e Nj.A.B në Bashkinë Lushnje është e organizuar në nivel sektori. Sektori i Auditimit të Brendshëm sipas strukturës së miratuar me V.K.B përbëhet nga tre persona. Aktualisht janë 3punonjës , 2 me profesion ekonomist dhe një jurist. Përgjegjësi i strukturës së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Lushnje është emëruar në shkurt të vitit 2024, i paçertifikuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (DHAB) (*Gjatë vitit 2024 dhe 2025 nga Ministria e financave nuk është nxjerrë urdhri per çertifikimin e e Adituesve të brendshëm në sektorin publik)* dhe dy specialistë janë çertifikuar në Korrik 2023.Për periudhën janar –shtator Znj.E.Prifti ka qenë me raport lindje dhe është zevendësuar nga Znj.Y.Gjoni (specialiste e

pacertifikuar për auditimin) .Tetor 2025-31dhjetor 2025 është kthyer në punë nga raporti i lindjes,Znj.E.Prifti.



-Puna brenda strukturës është e organizuar pa përgjegjës grupi ,në auditim marin pjesë të tre punonjësit e zyrës (Përgjegjësi dhe dy audituesit).
Sektori i Auditimit të Brendshëm është në varësi direkte nga Kryetari i Bashkisë.

-Kuadri ligjor

Struktura e AB është organizuar dhe funksionon në zbatim të:

- Ligjit nr.114,date 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik" (i ndryshuar);
- Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100,datë 25.10.2018 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik'' (i ndryshuar);
- Urdhër Nr. 103, datë 23.07.2025 "Për miratimin e standarteve globale të auditimit të brendshëm të pranuara për zbatim në sektorin public në Republikën e Shqipërisë"
- VKM nr.83,datë 03.02.2016''Për miratimin e kritereve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik'' (i ndryshuar);
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (i ndryshuar).
- Ligji Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar)
- Urdhri nr. 196, datë 12.12.2018 i Kryetarit të Bashkisë Lushnje " Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Lushnje" ndryshuar me vendim nr.36/1 datë 06.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë;
- Ligji nr.9936 datë 26.06.2008''Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë''(i ndryshuar)
- Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore'
- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit" (i ndryshuar).
- Ligji nr.9632 ,date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar)
- Ligji nr.9920,datë19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).
- Ligji 162/2020 " Për prokurimin Publik" (i ndryshuar)
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar)
- Ligji nr.10352 datë 18.11.2010''Për Artin dhe Kulturën''(i ndryshuar).
- Ligji nr.79/2017 ''Për sportin'' (i ndryshuar).

- Aktet te tjera ligjore e nënligjore të sisteme/fushave përkatëse objekt auditimi.

- ***Objektivat strategjik të njësisë së Auditimit të Brendshëm.***

Objektivat strategjikë të auditimit të brendshëm janë:
Të nxisë politikat e qeverisjes së mirë , përmirësimin dhe forcimin e kontrollit të brendshëm në të gjitha subjektet e audituara.
Programimi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, sipas kërkesave të menaxhimit,duke ruajtur frekuencën e auditimit ,vlerësimin e riskut ,ekspozimin e tij dhe nivelin e materialitetit.
Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e tij duke u fokusuar kryesisht në:
-Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
-Përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
-Ruajtjen e aseteve;
-Besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
Ndjekja në vazhdimësi e rekomandimeve të dhëna nga auditimet bazuar në planin e veprimit për ndjekjen e tyre;
Minimizimi i kostos së auditimit duke u përqendruar në sistemet apo fushat me risk të lartë e të mesëm;
Auditimi i Brendshëm është një instrument menaxherial efektiv, që ofron këshilla dhe garanci objektive të pavarur për Grupin e Menaxhimit Strategjik, për titullarin, apo drejtues të tjerë, lidhur me faktin se sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit janë vendosur në përputhje me rregullat dhe standardet si dhe me parimet e menaxhimit financiar.

- **Identifikimi i subjekteve**

Veprimtaria audituese do të perqendrohet kryesisht në identifikimin dhe klasifikimin e subjekteve me tregues potencial për nga rëndësia, madhësia në nivel të kërkesave për buxhet ,burimet njerëzore etj, kryerjen e angazhimeve audituese vlerësuar mbi bazë risku. (pasqyra nr.1) .Auditimet programohen me frekuence 1 here në dy vjet ose 1 herë në vit. Për periudhën 2026-2028 janë identifikuar për t'u audituar 13 drejtori të Bashkisë, 4 institucione vartëse, të cilat janë njësi shpenzuese me buxhet më vete dhe 15 njësi administrative, gjithsej 32 subjekte. Konkretisht subjektet e identifikuara për tu audituar janë:
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Drejtoria e të Ardhurave Vendore
Njësia për hartimin e Projekteve dhe Integrimin Evropian
Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Asetet
Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Drejtoria e Marrdhënieve me Publikun
Drejtoria e Policisë Bashkiake
Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit
Qendra e Personave me Aftësi të Kufizuar
Drejtoria e Zhvillimit Rural
Drejtoria e Planifikimit , Zhvillimit të Territorit

Drejtoria e Shërbimeve Publike
Drejtoria e Shërbimit Social dhe Kujdesit Shëndetësor
-Institucionet Vartëse:
1-Qendra e Arsimit
2-Qendra e Kulturës &Klubsporti
3-Ndërmarrja e Pasurisë Publike
4-Sh.A.Klubi i Futbollit „Lushnja 1930"
15 Njësi Administrative (nr.1,2,3,4,5) Allkaj, Ballagat, Bubullimë,Dushk, Fiershegan, Golem,Hysgjokaj,Karbunarë, Kolonjë , Krutje.
Bazuar në kërkesat e kuadrit ligjor të përmendura më sipër veprimtaria audituese për vitet 2026-2028, do të përqëndrohet kryesisht si dhe në auditimin e bashkisë në disa fusha me më shumë rrisk duke marrë parsysh dhe rekomandimet e lëna nga KLSH. si dhe në auditimet e kombinuara në subjektet e varësisë .
Per secilën organizatë kemi identifikuar riskun e auditimit (shiko pasqyren nr 1) dhe kemi përcaktuar fushat e auditimit për të gjitha njësitë që do të auditohen per vitin 2026 – 2028.Për bazë kemi marrë vlerësimin e riskut si per mjedisin e përgjithshëm dhe riskun per fusha te veçanta te auditimit brenda cdo njësie që do të auditohet:

- **Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare.**

Orientimi kryesor i Njesise se Auditit te Brendshëm janë Fushat ose sistemet qe paraqesin risk me te larte. Sipas subjekteve janë identifikuar fushat si vijon:
Menaxhimi i burimeve njerzore, Detyrimet e prapambetura për bashkinë dhe njësitë vartëse, planifikimi dhe buxhetimi, raportimi financiar dhe kontabiliteti, zbatimi i procedurave të prokurimeve publike, aktivet e qëndrueshme, menaxhimi i aseteve, funksionimi i kontrollit të brendshëm, pagat dhe shpërblimet ,menaxhimi i ujitjes e kullimit, qendra e personave me aftësi të kufizuar, investimet e punëve publike dhe kontratat, Administrimi i vlerave materiale dhe monetare; zbatimi i tarifave dhe afateve të shërbimit ,tarifave të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit etj. Auditimi i fondeve të BE-së në rast se do ketë si dhe shërbimet e tjera që ofron Bashkia.
Institucionet në vartësi :

Qendra e Kulturës &Klub shumë sporteve
Qendra e Arsimit
Ndërmarrja e Pasurisë Publike

Shoqëri Aksionere Klubi i Futbollit "Lushnja 1930".

- **Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.**

Në Bashkinë Lushnje janë 32 subjekte për tu audituar (13 drejtori të bashkisë , 4 ndërmarrje dhe institucionet në varësi të bashkisë dhe 15 njësi administrative).
Në planifikimin e nivelit të risqeve jemi bazuar në kompleksitetin e subjektit objekt auditimi, fushat e veprimtarisë, buxhetin, burimet njerezore, frekuenca e auditimit, gjetjet e mëparshme të auditimit etj. Subjektet e vartësisë së bashkisë janë vlerësuar me rrisk të mesëm dhe sistemi

i prokurimeve ,detyrimet e prapambetura me rrisk të lartë ,ndërsa menaxhimi i aktiveve të qëndrueshme me rrisk të ulët .

Vlerësimi i përgjithshëm i rriskut është i mesëm .

Për ato fusha që janë me rrisk të lartë frekuenca e auditimit është çdo vit.

Ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë janë:

Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Pasurise Publike.

Qendra e Kulturës &Klubsporti .

Qendra e Arsimit.

Klubi i Futbollit „Lushnja 1930“ sh.a.

Janë 4(katër)njësi shpenzuese me llogari më vete mbulohen me auditim sipas vlerësimit të rriskut. Brenda bashkisë janë identifikuar gjithsej 15 fusha me rrisk të mesëm që janë 10 njësitë administrative (ish komunat) dhe 5 njësitë administrative në qytet. Në vlerësimin e rriskut jemi nisur nga rezultatet e auditimeve të mëparshme për subjektet e fushat e parashikuara për auditim .

Në hartimin e planit Strategjik kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

Njësia e auditimit të shpenzojë më shumë kohë për fushat e reja dhe me rëndësi për Bashkinë.

Për fushat me rrisk të lartë të shpenzojë më shumë kohë.

Kur një sistem apo fushë ka ndryshuar ,rrisku rritet ,prandaj AB do të mbajë parsysh këto ndryshime.

Auditimi të marrë në konsideratë shqetësimet e menaxherëve.

• Kufizimet e auditimit `

Numri i vogël i audituesve tre persona, perfshirë dhe përgjegjesi i sektorit te auditimit nuk është i mjaftueshëm per te respektuar frekuencen e auditimit te pershkruar me siper.

Mungesa e bashkëpunimit reciprok dhe përgjegjshmëria e subjekteve që auditohen.

Mungesa e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve nga vetë subjektet që auditohen.

• Prioritete për vitet 2026-2028

Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve .

Monitorimi i sistemit të raportimit të të dhënave për veprimtarine e AB.

Sigurimi i cilësisë së auditimit.

Zhvillimi i veprimtarisë së auditimit sipas standarteve të AB në të gjitha etapat.

Ofrimi i sigurisë te menaxhimi që veprimtaria e AB të konsiderohet si shtim vlere dhe përmirësim i aktivitetit të subjekteve.

Bashkangjitur Planit Strategjik janë dhe pasqyrat e plotësuara si më poshtë

Pasqyra nr1,"Vlerësimi i nivelit të rriskut për subjektet për vitet 2026-2028"

Pasqyra nr2,"Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2026-2028".

II.Planit Vjetor i auditimit për vitin 2026

- **Zhvillimet aktuale të NJAB**

Sektori i AB në Bashkine Lushnje për vitin 2025 ka një plan vjetor të miratur nga titullari Bashkisë për ushtrimin e 8 auditimeve, prej të cilave 6 auditime janë realizuar. Nga 9-të auditimet që kanë qenë të planifikuara për tu realizuar presim të realizojme 8 auditime.
Kemi ndryshim të planit vjetor të miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr.23 protokoll dt.16.01.2025 dhe urdhrit të Kryetarit nr.290 protokoll dt.15.10.2025.Ndryshimet e planit vjetor të auditimit pasi janë arsyetuar me shkrim, janë miratuar me urdhër nga Kryetari i Bashkisë, dhe me pas, janë dërguar me shkresë përcjellëse për informim Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave. Mbetet pa audituar Qendra e Arsimit Lushnjë dhe Ndërmarja e Pasurisë Publike, pasi janë audituar nga KLSH.
Sipas Planit te vitit 2025 të miratuar është në proces 1(një)auditim i kombinuar,Qendra e Kulturës dhe Klubi Shumesportit.
Janë realizuar këto Auditime deri në 31.08.2025
1-Auditimi i vlerësimit të statusit të zbatimit të rekomandimeve.
2- Auditimi i përputhshmërisë Detyrimet e prapambetura ne Bashki dhe njësitë Vartëse .
3-Auditim i përputhshmërisë (Nj.ad Bubullimë ,Karbunarë).
Në proces tani :
4-Auditim i kombinuar - Qendra e Kulturës dhe Klubit Shumësportit në proces.
Deri në 31.12.2025 do të zhvillohen dy auditime :
1-Auditim i kombinuar –Drejtoria e të ardhurave vendore .
2-Auditim përputhsshmërie Nj.administrative Hysgjokaj.
Deri në 31.12.2025 do të realizohen gjithsej 8 auditime për vitin 2025.

- **Prioritetet e auditimit për vitin 2026**

Kryerja e raportimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa kufizime me menaxhimin e lartë për të arritur një shkallë pavarësie për përmbushjen me efektivitet të përgjegjësive që përcakton ligji.
-Monitorimi i strukturës së AB, sigurimi i cilësisë së auditimit.
-Ngritjen dhe zhvillimin profesional të audituesve.
-Planifikimi i planeve të auditimit duke përcaktuar përparësitë e aktivitetit të auditimit të brendshëm në linjë me synimet e organizatës që do të auditohet.
-Sigurinë se burimet e auditimit janë të përshtatshme,të mjaftueshme dhe të shpërndara në mënyrë efektive për të përmbushur planin e miratuar.
-Dhënia e rekomandimeve të përshtatshme për përmirësimin e procesit të qeverisjes së organizatës.
-Vendosja e një mirëkuptimi të shkruar mes palëve mbi objektivat,fushën,përgjegjësitë përkatëse dhe pritshmëri të tjera,duke përfshirë kufizime për shpërndarjen e rezultateve të angazhimit dhe aksesin në të dhënat e angazhimit.
-Vendosja e proçedurave për tu siguruar se çdo rekomandim i bërë nga NjAB, zbatohet ashtu siç duhet, në mënyrë që të evidentohen të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm për përmirësimin e kontrolleve të brendshme.

-Në auditimet e planifikuara për vitin 2026, në subjektet e varësisë së bashkisë dhe brenda bashkisë struktura e auditit të brendshëm do të ketë prioritet në programet e angazhimit të auditimit detyrimet e prapambetura si gjatë vitit ushtrimor si edhe ato të krijuara nga vitet e mëparshme si dhe gjurmën standarte të auditimit të këtij proçesi.

- **Objektivat kryesore për vitin 2026**

Struktura e Nj.A.B ka si objektiva vjetore kryesore:

Programimin dhe kryerjen e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimeve të plota sipas subjekteve një herë në vit dhe një herë në dy vjet, në varësi të vlerësimit të sistemeve, fushave të llogarisë, riskut, materialitetit rendësisë se efekteve negative dhe faktorëve ndikues të jashtëm.

Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tij.

Minimizimi i kostos së auditimit duke u përqëndruar në sistemet dhe fushat me risk më të lartë.

Rritja e cilesisë dhe performancës së auditimeve duke shtuar vlerë në përmirësimin e menaxhimit.

- Shfrytëzimi i burimeve njerëzore të sektorit në mënyrë efektive dhe efiçente.

Raportimi tek Titullari i Njësisë Publike kur zbulohen parregullsi apo veprime ,që përbëjnë vepër penale.

- **Programimi i llojit të angazhimeve**

Sektori i AB në Bashkinë Lushnje për vitin 2026 ka planifikuar të kryejë gjithsej 8 (tetë) auditime , nga këto :

1-Auditimi të kombinuara në njësitë shpenzuese në varësi të bashkisë 2(dy).

2-Auditim i kombinuar në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në Bashki 1(një).

3-Auditim përputhshmërie në Njësitë administrative 3(tre).

1-Auditim përputhshmërie "Detyrimet e prapambetura ne Bashki dhe njësitë Vartëse për vitin 2025" 1(një).

1-Auditim mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin e mëparshëm.

Njësitë vartëse janë :

1- Qendra e Arsimit .

2- Sh.A.Klubi i Futbollit Lushnja 1930.

1-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki.

Njësitë administrative janë :

1-Njësia Administrative Ballagat.

2-Njësia Administrative Golem .

3-Njësia Administrative Fiershegan.

1-Auditim i detyrimeve të prapambetura në bashki dhe njësitë vartëse për vitin 2025.

2-Auditim mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin e mëparshëm 2025.

Më hollësisht është raportuar në pasqyrën nr.3 të plan angazhimeve të vitit 2026.

- **Planifikimi burimeve për vitin 2026**

Për zbatimin e objektivave të përcaktuara në programin e auditimit për vitin 2026 do të synohet në menaxhimin e burimeve njerëzore të brendshme të Sektorit të Auditimit .Aktualisht njësia e auditimit mbështetet në kapacitetet e saj ,por në raste të tjera ajo mund të mbështetet dhe me

marrjen e ndonjë specialisti në rast të nevojave .Në zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore do të konsiderohen dhe do të bëhet një vlerësim i rregullt i bashkëpunimit ndërmjet njësisë tonë të auditimit me strukturat më të larta të Auditimit të Brendshëm për tu siguruar që puna audituese të mos ketë dublime.

Gjithashtu do të ruhet qëllimi i auditimit duke ruajtur parimin e pavarësisë funksionale dhe organizative të auditimit.

Planifikimi i burimeve për vitin 2025.

Burimet e planifikuara janë :

Koha maksimale e vlefshme	780 ditë (52 javë x 5 ditë x 3persona).
Pushimet vjetore	66 ditë (22ditë pune/person x 3persona)
Ditë pushimi (Festa Zyrtare)	30 ditë (10 ditë x 3 persona)
Pushime për arsye shëndetësore	15ditë (5 ditë x 3 persona)
Angazhime në trajnime	15ditë (5 ditë x 3 persona)
Angazhime në mbledhje/takime	12ditë (4 takime çdo tre muaj)
Rezerva të Planifikuara(të papritura)	21ditë (7 ditë x 3 persona)
Totali	621 ditë (207ditë për person)

- **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim për vitin 2026**

Stafi i NJ. AB duhet të zoterojë aftesitë dhe kapacitetet e duhura për realizimin e veprimtarisë së auditimit. Për vitin 2026 në Njësinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Lushnje do të trajnohet :

1- Përgjegjësi i Njesisë së auditimit për çertifikatën e audituesit të brendshëm .

2- Përgjegjësi i Njësisë së AB për vitin 2026 së bashku me dy punonjësit do të ndjekë trajnimin sipas Ligjit nr.114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"(i ndryshuar). Janë planifikuar 5 ditë trajnime për të plotësuar kërkesat ligjore prej 40 orëve trajnime në vit. Propozimet për trajnime janë bërë bazuar në vështirësitë e konstatuara gjatë vitit të mëparshëm.

- **Planifikimi i Kostos për vitin 2026**

000/leke

Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
	1	2
1	Buxheti Gjithsej	4,150
2	Paga Sig.Shoqërore dhe shendetsore.	3,950
3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	0
4	Të tjera	200
5	Numri i Punonjësve	3
6	Kosto për Person (1/3)	1,383

Kostoja paraprake e llogaritur është bazuar në elementet e saj si paga bruto aktuale(nr.i punonjesve, paga sipas diplomës, paga sipas pozicionit,vjetërsia), Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, shpenzime për kancelari, shpenzime për 2kompjutra etj.
Nuk jane planifikuar shpenzimet për udhëtim e dieta sepse nuk mbulohen nga institucioni i Bashkisë .
Në planifikimin e kohës së punës janë marrë parasysh:
a.Koha e punës për auditim.
b.Koha për mbikqyrjen -ku përgjegjësi rishikon të gjithë punën audituese për të siguruar cilësinë në auditim .
c.Koha për trajnim për rritjen profesionale të stafit të NJAB.
Më hollësisht është raportuar në pasqyrën nr.5 në planifikimin vjetor të buxhetit dhe shpërndarja e burimeve njerëzore të NjAB për vitin 2026.

- **Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

Sigurimi i brendshëm i cilësisë së punës së audituesve bëhet gjatë gjithë angazhimit. Ky proçes është i rëndësishëm të përcaktohet në planin e përgjithshëm të angazhimit. Kjo bën të mundur që të mos ketë vonesa të shkaktuara nga grupi i auditimit të brendshëm, që gjatë angazhimit duhet të rishikojë punen e kryer gjatë një faze , para se të kalojë në fazën tjetër. Vlerësimi i vazhdueshëm i cilësisë të veprimtarisë së auditimit të brendshëm bëhet sipas një programi të miratuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë nga Kryetari i bashkisë. Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe performancës së auditimit të brendshëm përcakton nëse procedurat janë zbatuar në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për fushën e auditimit të brendshëm.

Në auditimet e zhvilluara kemi parasysh 3komponentë të programit të cilësisë:

- Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë.
- Vetëvlerësimi periodik.
- Reagimet e subjektit të audituar.
- Tre komponentët e sigurimit të cilësisë, realizohen nga njësia e auditimit .

Gjatë sigurimit të brëndshëm të cilësisë është marrë parasysh:
-Komunikimi dhe raportimi me shkrim i audituesve, pasi ai duhet të jetë i saktë, objektiv,i qartë, konçiz, në kohë dhe konstruktiv dhe raportimi i të gjitha gjetjeve pavarësisht natyrës dhe rendësise së tyre.
Bashkangjitur ju dërgojmë formatet e planit strategjik 2026-2028 dhe planit vjetor 2026:

1. Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitet 2026-2028.
2. Plani strategjik i subjekteve të synuara për t'u audituar për vitet 2026-2028.
3. Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2026.
4. Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të specialistëve të NJAB për vitin 2026.
5. Planifikimi vjetor i buxhetit dh shpërndarja e buriemve të NJAB për viitn 2

Sektori i Auditimit të Brendshëm